



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria –Vlada-Government
Ministria e Financave –Ministarstvo za Finansije- Ministry of Finance
Agjencia Qendror e Prokurimit /Centralna/Agjencia/
Nabavke/Central/Prokurimet/Agency

Bazuar në Ligjin për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës Nr.03/L-149, Rregulloren Nr.02/2010, për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës dhe Rregullores Nr.21/2012, për Avancim në Karrierë të Nëpunësve Civil, Agjencia Qendror e Prokurimit shpall:

KONKURS PËR AVANCIM NË KARRIERË

Titulli të punës: : Zyrtar i Lartë i Prokurimit
Kategoria funksionale: Nivel Profesional / Koefficienti 8
Numri i referencës së vendit të punës:09/2018
I raporton: Drejtorit të Drejtoratit për Procedura të Veçantat AQP-së
Orar i plotë i punës: PO
Vendi: Prishtinë

Qëllimet e Vendit të Punës: Sigurimi i prokurimit për të gjitha shpenzimet e institucionit si dhe ofrimi i ekspertizës profesionale lidhur me zbatimin dhe zhvillimin e strategjive të prokurimit

Detyrat dhe Përgjegjësitë: Nën mbikëqyrjen e Drejtorit të Drejtoratit për procedura të Veçanta ,kryen detyrat dhe përgjegjësitë si në vijim:

1. Harton planet e punës në pajtim me mbikëqyrësin për zbatimin e detyrave të përcaktuara në bazë të objektivave të njësisë dhe jep rekomandime lidhur me realizimin objektivave të njësisë;20%
2. Udhëheq grupet punuese në fushën profesionale specifike kur kërkohet dhe kryen detyra të specializuara në fushën specifike si dhe ndihmon stafin tjetër të institucionit në realizimin e detyrave dhe përgjegjësi të tyre; 15 %
3. Në bashkëpunim me mbikëqyrësin analizon dhe vlerëson realizimin e objektivave dhe planit të punës të njësisë dhe harton raporte mbi progresin e arritur dhe rekomandon përmirësime nëse kërkohet; 15%
4. Siguron që të gjitha kërkesat për prokurim janë në pajtim me legjislacionin dhe rregullat e prokurimit publik; 15 %
5. Përgatit kontrata dhe siguron që metodat e prokurimit dhe teknikat janë të kuptueshme dhe zbatohen nga ana zyrtaret tjerë të prokurimit; 10%
6. Përgatit forma dhe procedura standarde, varësisht nga metoda e prokurimit dhe siguron që ftesat për oferta për tenderë dhe dërgimi i tyre është bërë me kohë; 10%

7. Siguron mbajtjen e të dhënave detale për të gjithë ofertuesit pjesëmarrës, për veprimet dhe vendimet e marra, si dhe nënshkrimi i komenteve nga secili anëtar;5%

8. Kryen edhe punë tjera në pajtim me qëllimin e vendit të punës të cilat mund të kërkohen kohë pas kohe nga mbikqyersi;5%

Kualifikimet, Përvoja e punës dhe aftësitë:

- **Diplomë universitare, Drejtimet Ekonomik, Juridik, Administratë, Biznes, Shkenca Shoqërore**
- **Minimum 3 vite përvojë pune profesionale.**
- **Njohuri të thellë dhe të specializuar në fushën e prokurimit publik;**
- **Njohuri të ligjeve dhe rregulloreve të aplikueshme;**
- **Shkathtësi në komunikim planifikim të punës dhe udhëheqje të ekipit;**
- **Shkathtësi hulumtuese, analitike, vlerësuese dhe formulim të rekomandimeve dhe këshillave profesionale;**
- **Aftësi për përmbushje të detyrave dhe punëve nën presion**
- **Shkathtësi kompjuterike në aplikacione të programeve (Word, Excel, Power Point, Access);**

Procedurat e konkurrimit: Avancim

Konkursi është i hapur për të gjithë shërbyesit civil të AQP-së.

Konkursi është i hapur tetë (8) ditë pas datës së shpalljes.

Data e fundit e aplikimit është: 05/11/2018

Marrja dhe dorëzimi i aplikacioneve: Aplikacionet merren dhe dorëzohen në AQP, ndërtesa e ish Gërmisë, kati V, zyra e personelit A/501, si dhe në nr. e tel:038/213/650, centrix:200/15/511 prej orës 08:00 deri në orën 16:00.

Aplikacionit i bashkëngjiten kopjet e dokumentacionit mbi kualifikimin; dëshmi për përvojën e punës; dhe dokumentacionet tjera të nevojshme që kërkon vendi i punës për të cilin keni konkuruar.

Kandidatët që përzgjidhen për listën e ngushtë, do të informohen me shkrim ose me telefon në afat ligjor nga personeli.

Shërbimi Civil i Kosovës u shërben të gjithë banorëve të Kosovës dhe mirëpret aplikimet nga femrat dhe meshkujt e të gjitha komuniteteve të Kosovës.

Komuniteti jo shumicë dhe pjesëtarët e tyre kanë të drejtë për përfaqësim të drejtë dhe proporcional në organet e Shërbimit Civil, siç e specifikon Neni 1, paragrafi 3, i Ligjit Nr.03/L-149 mbi Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës.

- Kërkesat e dërguara pas datës së fundit nuk do të pranohen.
- Kërkesat e pakompletuara do të refuzohen.